



AVOKATI I POPULLIT
Nr. 93/1 Prot.
Datë, më 22. 08. 2023

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PROKURORIA E PËRGJITHSHME
DREJTORIA E KOORDINIMIT INSTITUCIONAL
SEKTORI I DEKRIMINALIZIMIT

Nr. 1313/1 Prot

Tiranë, më 21. 08. 2023

Lënda: Kthim përgjigje

AVOKATIT TË POPULLIT
Adresa: Bulevardi "Zhan D'Árk", Nr.2,

TIRANË

Në përgjigje tuajës nr.93 prot., datë 16.08.2023, regjistruar në Prokurorinë e Përgjithshme me nr.1313 prot., datë 16.09.2023, ju sqarojmë se:

Në zbatim të pikës 2 të nenit 31 dhe pikës 2 të nenit 129 të ligjit nr.115/ 2016 "Për organet e qeverisjes së shtetit të drejtësisë", i ndryshuar, keni kërkuar, në Prokurorinë e Përgjithshme, kryerjen e verifikimit të thelluar të të dhënave të plotësuara në Formularët e Vetëdeklarimit, në zbatim të ligjit nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", për 38 (tridhjet e tetë) subjekte/persona, të listuar bashkëlidhur kësaj shkrese, kandidatë (avokatë) për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Sektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme pasi shqyrtoi paraprakisht kërkesën tuaj, ju bën me dije se Ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimi nr.17/2016 i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", nxjerrë në zbatim të ligjit, kanë ngarkuar specifikisht, organet përgjegjëse për administrimin e formularëve të vetëdeklarimit, (në rastin konkret, titullari i Komisionit të Pavaruar Ad Hoc¹, nëpërmjet strukturës përkatëse), të cilat në zbatim të Kreut V, pika 1, 2, 3, 4 dhe Kreut VI të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit të Shqipërisë, duhet të verifikojnë paraprakisht të dhënat e deklaruara nga subjektet e parashikuara në nenet 2 dhe 3, të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

¹ Pika 2 e nenit 31 dhe pika 2 e nenit 129 të ligjit nr.115/2016

Organet përgjegjëse, kryesisht, bëjnë publike faktet e paraqitura në formularët e vetëdeklarimit, kërkojnë informacion pranë Zyrës së Gjendjes Gjyqësore dhe Zyrës së Gjendjes Civile dhe kërkojnë verifikim të plotë e të thelluar, nga Prokuroria e Përgjithshme, për rastet kur;

- subjektet nuk kanë deklaruar asnjë fakt që ka të bëjë me të kaluarën e tyre penale por ka indicie mbi bazën e një kërkesë, ose kryesisht kur ka të dhëna apo fakte, përfshirë ato të njohura botërisht për një të kaluar penale, apo kur rezultojnë të dhëna të ndryshme nga sa janë deklaruar në formular;
- dhe për rastet kur personat kanë deklaruar të dhëna për të kaluarën e tyre penale, por organi përgjegjës vlerëson se duhen përcjellë për të verifikuar saktësinë e deklarimeve.

Spektori i Dekriminalizimit në Prokurorinë e Përgjithshme përfshihet në procesin e verifikimit, vetëm në rastet që parashikon ligji nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", pra, vetëm kur ka nevojë për verifikime të thelluara, të cituara më sipër.

Në kërkesën tuaj, si organi përgjegjës për administrimin e formularëve, konstatohet se nuk është kryer verifikimi paraprak nga ana juaj në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", i cili duhet të përmbajë indicie apo të dhëna për dënime penale.

Spektori i Dekriminalizimit, pranë Prokurorisë së Përgjithshme, pasi të verifikojë që kërkesa ka përmbushur të gjitha kriteret ligjore, do të kryejë verifikim të thelluar, i cili do të përmbillet brenda një afati minimal prej 3 (tre) muajsh, në zbatim të ligjit nr.38/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe vendimit nr.17/2016, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr.138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike".

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin,

DREJTORI

KOSTAQ BELURI

